

**STATUTI DHE AKTI I THEMELIMIT I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“ENDURANCE AND LAW ALBANIA” SHPK**

Ne kete statut

- "Ligji" eshte Ligji Nr 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqeritë tregtare";
- "Statuti" është Statuti i shoqerise;

**KREU I**  
**THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA**

**Neni 1:**  
**Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

- 1) Sot, më 18.05.2024 themeluesi, ka krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin "**ENDURANCE AND LAW ALBANIA**" SHPK.
- 2) Themeluesi i shoqerisë eshte: Klodjan Reçi, shtetas Shqiptar identifikuar me anë të kartes se identitetit me numër J10522086J i datëlindjes 22.05.1991, lindur në Peshkopi dhe banues në Tirane; madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

**Neni 2:**  
**Objekti**

- 1) Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:  
Import -Export me SHBA të materialeve të bletarisë të cdo lloji që lidhen me këtë aktivitet.  
Shërbime ndërmjetësimi të turizmit dentar, turizmi blegtoral, turizmi malor.  
Aktiviteti në fushën e avokatisë, detektivit privat, shërbimeve të makinave me qira.  
Sherbime sociale ndermjetesim, aktivitet ne fushen e siguracioneve TPL.  
Studimi çeshtjes ligjore, Konsulencat ligjore, avokatore, dedektiv priva, takimet me kliente, perplimi i kerkesave.)  
Shërbime jashtë orarit 16:30 si dhe ne rastin e festave Zyrtare apo diteve te pushimit e Shtune dhe e Diele.

**Neni 3:**  
**Kohëzgjatja**

- 1) Kohëzgjatja e shoqerisë është e pacaktuar.

**Neni 4:**  
**Selia**

- 1) Shoqëria e ka selinë në TIRANE, Rr. Grigor Gjirokastriti, Fusha Aviacionit Ndertesa 29/2 Tirane
- 2) Me vendim të organit administrativ, shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

**KREU II**  
**KAPITALI**

**Neni 5**  
**Kapitali themeltar**

- 1) Kapitali themeltar fillestar i shoqerisë është 100 (njeqind Lekë). Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqerisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues Klodjan Reçi zotëruesh i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100 (njeqind ) Lekë, që përben 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- 2) Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

**Neni 6:**  
**Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

- 1) Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti te autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.
- 2) Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak pér të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.
- 3) Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kerkohen pér ndryshimin e statutit.
- 4) Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

**Neni 7**  
**Transferimi i kapitalit**

- 1) Kuatat e kapitalit të shoqërisë e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
  - a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
  - b) shitblerjes;
  - c) trashëgimisë;
  - d) dhurimit;
  - e) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
- 2) Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, pér sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.
- 3) Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

**KREU III**  
**ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

**Neni 8**  
**Organi Vendimmarrës**

- 1) Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.
- 2) Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te përcaktuara ne ligj
- 3) Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse pér marrjen e vendimeve pér shoqërinë pér çështjet e mëposhtme:
  - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) ndryshimet e statutit;
  - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
  - d) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - e) përcaktimin e shpërblimeve pér personat e përmendor në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
  - f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
  - g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- 4) Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
- 5) Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

- 6) Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

### Neni 9

#### Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblesë se Përgjithshme

- 1) Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
- 2) Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

### Neni 10

#### Kuorumi

- 1) Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.
- 2) Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.
- 3) Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumin të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

### Neni 11

#### Marrja e vendimeve

- 1) Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave te zotëruar te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zgogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- 2) Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si :
  - a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
  - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - d) përcaktimin e shpërblimeve
  - e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
  - f) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - g) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- 3) Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet pranë QKR për te pasqyruar ndryshimet ne skedën e shoqërisë.

### Neni 12

#### Përashtimi nga e drejta e votës

- 1) Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
  - a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
  - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
  - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
  - d) dhënen ose jo të përfitimeve të reja.
- 2) Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

### Neni 13

## **Administrimi**

- 3) Administratori i shoqërisë emërohet Klodjan Reçi, shtetas Shqiptar identifikuar me anë të kartes se identitetit me numër J10522086J i datëlindjes 22.05.1991, lindur në Peshkopi dhe banues në Tirane; madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me afat emërimi 5 vjeçar, duke filluar nga data e emërimit.
- 1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas.
- 3) Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

## **Neni 14 Kompetencat e Administratorëve**

- 1) Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:
  - a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
  - b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
  - c) kujdesen përmajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
  - d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet përmirësuese për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përparrë asamblesë së përgjithshme përmirësuese;
  - e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur përmirësuar rrëthanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
  - f) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin përmirësuar Qendrën Kombëtare të Biznesit;
  - g) raportojnë përparrë asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë përmirësuese;
  - h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- 2) Administratoret janë te detyruar te thërrasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:
  - a) sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston reziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
  - b) shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 përmirësuar qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
  - c) shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 përmirësuar qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- 3) Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.
- 4) Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërbilimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## **Neni 15 Përgjegjësitet e Administratorit**

- 1) Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, përmirësues i shkelje të ligjeve, përmirësues i shkelje të statutit, apo përmirësues i kryera gjatë administrimit të shoqërisë.
- 2) Pasojat e marrëveshjeve të pa miratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, përmirësues i përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.
- 3) Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:
  - a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mëjdis;

- b) tē ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm pér arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
  - c) tē vlerësojë me përgjegjësi çështjet, pér tē cilat merret vendim;
  - d) tē parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo tē mundshëm, tē interesave personalë me ata tē shoqërisë;
  - e) tē ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
- 4) Administratori, gjatë kryerjes së detyrave tē tij, përgjigjen ndaj shoqërisë pér çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përashtim tē rasteve kur, në bazë tē hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
- 5) Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave 1 e 2 tē këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës pér tē vërtetuar kryerjen e detyrave tē tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve tē kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
- 6) Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Pér Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:
- a) u kthen ortakëve kontributet;
  - b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
  - c) u shpérndan aktivet shoqërisë;
  - d) lejon që shoqëria tē vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë tē gjendjes financiare, duhej tē parashikohej që shoqëria nuk do tē kishte aftësi paguese pér tē shlyer detyrimet;
  - e) jep kredi.
- 7) Përveç padisë pér shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë tē drejtë tē ngrënë padi penale kundër administratorit.
- 8) Paditësit kanë tē drejtë tē ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë tē dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpérblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund tē ndalojë ngritjen e kërkësë padisë kundër administratorit pér gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit tē detyrës.

#### **KREU IV VITI FINANCIAR, EKSPERTET**

##### **Neni 16 Viti Financiar**

- 1) Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përashtimisht, viti i parë finansiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllt me 31 Dhjetor.

##### **Neni 17 Ekspertet**

- 1) Eksperti ka pér detyre qe tē kontrolloje tē gjithë dokumentacionin kontabël tē veprimtarisë ekonomiko tregtare tē shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë ne lidhje me kontrollet periodike tē ushtruara prej tij pér rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë tē tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.
- 2) Ne përfundim tē kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit reportin me shkrim pér nxjerrjen e rezultatit tē bilancit financiar vjetor si dhe pér atë pér kontrollet periodike tē ushtruara, tē cilat është i detyruar qe t'jua paraqesë e dorëzojë ne kohë ortakeve pér t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e tē drejtës vendimore qe ka.

#### **KREU V PRISHJA, RIORGANIZIMI I SHOQËRISË**

##### **Neni 18 Prishja dhe likuidimi**

- 1) Shpérndarje ose prishja e shoqërisë mund tē behet ne çdo kohe:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e saj;
  - b) me vendim të Asamblesë se Ortakeve;
  - c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
  - d) nëse nuk ka kryer veprimitari tregtare për dy vjet dhe nuk është njofuar pezullimi i veprimitarisë në përputhje me ligjin.
  - e) me vendim të gjykatës;
- 2) Ne ketë rast Ortakët marrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar ne çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtese " Shoqëri ne likuidim e sipër ".
- 3) Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguesve, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.
- 4) Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.
- 5) Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

**Neni 19**  
**Riorganizimi i shoqërisë, bashkimi, ndarja**

- 1) Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

**Neni 20**  
**Baza Ligjore**

- 1) Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne përputhje te plete me ketë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- 2) Për sa nuk parashikohet ne këtë statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjeter specifik ne Republikën e Shqipërisë.

**Neni 21**  
**Mosmarrëveshjet**

- 1) Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do të zgjidhen nëpërmjet organeve të posaçme të njoitura nga ligji.

**O R T A K U I V E TË M**  
**I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**"ENDURANCE AND LAW ALBANIA" SHPK**

(Emër, Mbiemër, Nënshkrimi)